

Të dhënat bazike për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit
Titulli i lëndës:	Vështirësitë specifike në të nxënë
Niveli:	Master
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I-rë (semestri i dytë)
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	E mërkurë, 16:00-17:30, Salla P2
Mësimdhënësi i lëndës:	Linda Salihu, Ligjëruese
Detajet kontaktuese:	linda.salihu@uni-pr.edu zyra 4
Përshkrimi i lëndës	<p>Vështirësitë specifike në të nxënë paraqesin një gjendje që tashmë në përmasa të gjera njihet si gjendje e cila çon drejt vështirësive serioze jo vetëm në të nxënë e lëndëve gjatë moshës shkollore, por shpesh edhe në moshën e rritur. Fëmijët me vështirësi specifike në të nxënë përballen me disa vështirësi jo të zakonshme të cilat mund ta pengojnë të nxënë e leximit (njohjen, rrjedhshmërinë dhe të kuptuarit e fjalëve); shkrimin (dorëshkrimin, drejtshkrimin dhe krijimin e punimeve me shkrim); rikujtimin, arsyetimin dhe organizimin të informatave, ose performimit në matematikë (kalkulimin dhe zgjidhjen e problemeve). Kjo lëndë është dizajnuar për të ofruar njohuri teorike për këto tema dhe shkathtësi praktike lidhur me identifikimin e fëmijëve me vështirësi në të nxënë si dhe për t'u ndihmuar atyre në përmirësimin dhe përjetimin e suksesit përmes zbatimit të metodave efektive të intervenimit. Edhe pse fëmijët dhe të rinjtë me vështirësi në të nxënë gjenden në çdo klasë, kjo gjendje shpesh neglizhohet në klasat e zakonshme ashtu që nevojat e tyre nuk adresohen fare. E përshkruar si dobësi në mesin e anëve të forta, gjendja e vështirësive specifike në të nxënë bëhet tejet komplekse sepse çdo fëmijë posedon një kombinim unik të talentit dhe anëve të forta e të dobëta. Nëse këta fëmijë nuk identifikohen dhe nuk trajtohen, gjasat janë të mëdha që ata të bëhen më shumë sesa një dështim arsimor (mendo këtu për mosvijimin dhe braktisjen e shkollës, punën e fëmijëve, delikuencën). Prandaj, identifikimi si dhe trajtimi i fëmijëve me vështirësi në të nxënë do të jenë në fokus të kësaj lënde.</p>
Qëllimet e lëndës	<p>Qëllimi i kësaj lënde është t'i aftësojë studentët për zbatimin e metodave të vlerësimit dhe strategjive të intervenimit përmes të cilave fëmijët me vështirësi specifike në të nxënë në mënyrë efikase dhe efektive do të përfshiheshin në procesin mësimor. Kështu studentët, pra profesionistët arsimorë, në mënyrë më efektive do të përballen me përgjegjësinë për t'ju shërbyer të gjithë fëmijëve në shkollë si dhe për t'ju ndihmuar e për t'i këshilluar të tjerët, si kolegët mësimdhënëses, prindërit, etj., në këtë drejtim. Në përgjithësi, kjo lëndë ka për</p>

	qëllim që me përmbajtjen dhe metodologjinë mësimore të saj të arrijë në mendjet dhe në zemrat e profesionistëve arsimorë në shërbim dhe para shërbimit.		
Rezultatet e pritura të nxënies	<p>Me përfundimin e lëndës pritet që studentët të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kuptojnë konceptet teorike dhe operacionale lidhur me metodat dhe strategjitë e vlerësimit dhe të intervenimit për fëmijët me vështirësi specifike në të nxënë; • Përgatisin dhe hartojnë një plan të detajuar me aktivitete konkrete për mënyrën e vlerësimit dhe të intervenimit, duke specifikuar dhe arsyetuar mjetet dhe materialet që do të përdoren; • Vlerësojnë dhe identifikojnë fëmijët me vështirësi specifike në të nxënë e leximit, shkrimit dhe matematikës; • Zbatojnë një numër të metodave të intervenimit për fëmijët me vështirësi në të nxënë e leximit, shkrimit dhe matematikës; • Zhvillojnë një të kuptuar të ndjeshëm për nxënësit që përparojnë me vështirësi dhe një qëndrim të shëndoshë ndaj punës së vet dhe ndaj nxënësve të cilëve ju shërbejnë, pavarësisht se sa sfidues ose të zgjuar mund të jenë ata. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në terren			
Kollokfiume, seminare	2	1	2
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	3	6	18
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2	4
Projektet, prezentimet, etj	1	1	1
Totali	17	80	140
Metodologjia e mësimdhënies:	Lënda do të zhvillohet përmes ligjëratave, diskutimeve, aktiviteteve në grupe të vogla dhe punës individuale. Ky do të jetë një mjedis i pasur akademik i dedikuar më tepër të nxënit përmes të bërit, sesa dhënies ekskluzive të leksioneve. Studentët do të jenë të angazhuar në diskutime interaktive të cilat planifikohen për reflektim dhe zbatim të pjesëve të caktuara të leximit e studimit si dhe reflektim për përvojat e tyre personale gjatë shkollimit duke i kombinuar ato me përvojat e fituara gjatë praktikës shkollore përmes analizimit të rasteve.		
Metodat e vlerësimit:	Vijimi i rregullt në orët e mësimit		10 pikë

	Pjesëmarrja aktive në mësim 20 pikë Kollokviumi 20 pikë Provimi përfundimtar 50 pikë <p style="text-align: right;">Gjithsej: <u>100 pikë</u></p>
Literatura	
Literatura bazë:	<p>Fletcher, J. M., Lyon, G. R., Fuchs, L. S., & Barnes, M. A. (2007). <i>Learning disabilities: From identification to intervention</i>. New York: Guilford Press.</p> <p>Jimerson, S. R., Burns, M. K., & VanDerHeyden, A. M. (2007). <i>Handbook of response to intervention: The science and practice of assessment and intervention</i>. New York: Springer</p> <p>Burns, M. K., & Gibbons, K. A. (2008). <i>Implementing response-to-intervention in elementary and secondary schools: Procedures to assure scientific-based practices</i>. New York: Routledge.</p> <p>Porter, J. & Lacey, P. (2005). <i>Researching learning difficulties: A guide for practitioners</i>. London: Paul Chapman Publishing.</p> <p>Tasevska, A. & Mitckovska, G. (2017). Përkrahja nxënësve me vështirësi në mësim: Doracak për bashkëpunëtorët profesional në shkollat fillore. Shkup: Byro për Zhvillimin e Arsimit.</p> <p>Salihu, L. & Räsänen, P. (2018). Mathematics skills of Kosovar primary school children: A special view on children with mathematical learning difficulties. <i>International Electronic Journal of Elementary Education</i>, 10(4), 421-430.</p> <p>Salihu, L., Aro, M., & Räsänen, P. (2017). Dynamic potential of feedback in self-regulated learning and motivation of children with mathematical learning difficulties. <i>Hrvatska Revija za Rehabilitacijska Istraživanja</i>, 53(2), 111-129.</p> <p>Salihu, L. (2010). Vështirësitë në të nxënë. Prishtinë: CDP+ WUS Austria & Universiteti i Prishtinës (dispencë).</p>
Literatura shtesë:	<p>Salihu, L., Aro, M., & Räsänen, P. (2017). Zhvillimi i shkathtësive për matematikë dhe lexim te nxënësit me vështirësi në të nxënë e matematikës. Kumtesat nga Konferenca Vjetore e Shkencës 'Java e Shkencës' 2016 (fq. 365-371). Prishtinë: MASHT.</p> <p>Berch, D. & Mazzocco, M. M. M. (2007). <i>Why is math so hard for some children: The nature and origins of mathematical difficulties and disabilities</i>. Baltimore: Brookes Publishing.</p> <p>Guerin, G., & Male, M. C. (2006). <i>Addressing learning</i></p>

	<p>disabilities and difficulties: How to reach and teach every student. Thousand Oaks CA: SAGE.</p> <p>Weinfeld, R., Barnes-Robinson, L., Jeweler, S., & Shevitz, B. (2006). Smart kids with learning difficulties: Overcoming obstacles and realizing potential. Waco TX: Prufrock Press Inc.</p> <p>Westwood, P. (2008). What teachers need to know about learning difficulties. Camberwell Vic.: ACER Press.</p>
--	---

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Kompleksiteti i vështirësive specifike në të nxënë: Shkaqet dhe karakteristikat
Java e dytë:	Përkufizimi, përshkrimi dhe klasifikimi i vështirësive në të nxënë
Java e tretë:	Vlerësimi i vështirësive në të nxënë: Procedurat e inçizimit (skrinimit) të gjendjes
Java e katërt:	Matjet e rezultateve të përgjithshme, matjet e bazuara në kurrikulë dhe matjet e zotërimit të shkathtësive të caktuara
Java e pestë:	Vendimmarrja e bazuar në të dhëna: Identifikimi i fëmijëve me vështirësi specifike në të nxënë dhe kategoria e deficitit
Java e gjashtë:	Vështirësitë specifike në të nxënë e leximit: <i>Njohja e fjalëve, rrjedhshmëria dhe të kuptuarit e leximit</i>
Java e shtatë:	Vështirësitë specifike në të nxënë e shkrimit: <i>Dorëshkrimi, drejtshkrimi dhe të shprehurit me shkrim</i>
Java e tetë:	Vështirësitë specifike në të nxënë e matematikës: <i>Kalkulimi dhe zgjidhja e problemit</i>
Java e nëntë:	Kollokviumi
Java e dhjetë:	Intervenimet për mbështetjen e grupit të zgjedhur të fëmijëve në klasën e rregullt: Parimet e përgjithshme të intervenimit
Java e njëmbëdhjetë:	Intervenimet intensive për fëmijët e veçantë: Përfitimet dhe dëmet e mundshme të intervenimit
Java e dymbëdhjetë:	Programi arsimor i individualizuar: Qëllimi dhe përmbajtja e dokumentit për PAI-n
Java e trembëdhjetë:	Mbikëqyrja e përparimit: Vlerësimi i përgjigjes (reagimit) të fëmijëve ndaj intervenimit
Java e katërmëdhjetë:	Pasojat afektive dhe sociale të vështirësive të patrajtuara në të nxënë
Java e pesëmbëdhjetë:	Vështrim retrospektiv në çështjet kryesore të elaboruara; udhëzime për provimin përfundimtar

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<ul style="list-style-type: none"> - Ardhja me kohë në orët e mësimit; - Secilit student i lejohet që të parashtojë pyetje apo të bëjë komente kur i jepet fjala; - Studentit nuk i lejohet t'i ndërhyjë tjetrit kur ai apo ajo e ka fjalën; - Ndalohet përdorimi i telefonave celularë për çështje private.